

## POLEMIKA PËR DIALEKTET PËR NJË UNIFIKIM GJUHËSOR

1. Para Kongresit të Manastirit, 1-9 nëntor 1908, kishte konfuzion, sepse nuk ishte rënë dakord për një alfabet kombëtar.

Mendja e mençur shqiptare e zgjidhi këtë problem në Kongresin e Manastirit si dhe në Kongresin e Dibrës, kur vendosën një alfabet të gjuhës shqipe me toskërishte, e gegërishten si kryedialekt, ashtu si vetë krerët e shqiponjës në flamurin tonë kombëtar. Të dhëna për Kongresin e Manastirit më 28.XI.1912 kemi në revistën “Leka”, nr. 11, të vitit 1937 dhe “Hafiz Ali Korça” nga dr. Ismail Ahmeti”, Shkup 1999, fq. 28-37.

Mbas vitit 1908 nuk mjaftoi copëtimi i trojeve shqiptare, por mbeti në skenën aktuale ky dualizëm gjuhësor.

Atëherë, çështja gjuhësore dhe ajo letrare mbetet e hapur, e trajtuar, por jo pa zgjidhje institucionale kombëtare. Domosdoshmërinë e këtij misioni e kanë shtruar albanologët tanë dhe të huaj me teza për një mendësi kombëtare e më pas shtetërore:

- Dhaskal Todhri: “Gjuhëshkrimi me një gatim prej gjithë dialekteve të Shqipërisë”.

- Faik Konica, tek “Albania”: Ishte parimisht për bashkimin e dy dialekteve, e diktuar nga rrethanat historike.

- Shoqëria e Stambollit ishte përkrahësja e shkrirjes së dy dialekteve shqipe, edhe pse Kristoforidhi ishte për një gegnishte të mesme që t’i afrohej në shumë pika ortografisë toskërishte.

Në këto linja diskutimesh vijuan secili me tezën e vet, që nga Komisia Letrare (Shkodër, 1917) dhe në tërë aktivitetet e shtetit shqiptar.

Mikel Breal, profesor i gramatikës së krahasuar në Francë, shprehet: “Asnjë komb në Europë nuk ka një ortografi të tërë

logjike që t'i përgjigjet besnikërisht fillim e mbarim një sistem i vetëm".

Janë tri burime që përkojnë me interesat e vendit:

*E para:* Akademia e Shkencave të Shqipërisë (Me institucionet përkatëse të albanologjisë, historisë, gjuhësisë, etnografisë etj.).

*E dyta:* Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.

*E treta:* Diaspora.

Dy të parat, në Shqipëri dhe në Kosovë, mbas vitit 2000 nuk mund të bëjnë akademinë e vjetër paternaliste ndaj të tretëve, për të mos i reformuar sipas përvojës dhe argumenteve më të mira.

Edhe në "Shezjat", nga E. Koliqi janë bërë punime albanologjike në Romë e Mynih dhe me Franz Babingerin e personalitete të tjera të Perëndimit, duke merituar vlerësimin e mendimit të tyre në interes kombëtar.

Dihet që shkrimet fetare janë më të vjetrat. Dialekti arbëresh dhe përfaqësuesit e tyre janë fond i artë i gjuhës sonë letrare.

Kolë Kamsi në shkrimin "Një dorëshkrim i panjoftun i At Anton Santorit" (Hylli i dritës, gusht 1943, fq. 306), si dhe Karl Gurakuqi me shkrimin "Në mes arbëreshëve t'Italisë etj., treguan se për vendin punohet pa xhelozë krahinore, pa urrejtje politike dhe së bashku jepet shembulli kombëtar i një gjuhe letrare të pranuar nga të gjithë.

"Të paktën në kohën e Buzukut gjuha shqipe na paraqitet më e njëjtë sesa na paraqitet më vonë" (Namik Resuli, fq. 21, vepër e cituar).

Në divergjenca ka mjaft pasion, hipoteza e aspak teza, pretendime, por që i mungojnë argumentet, por ka brumë ideologjik që e ndan, e përçan rrugën e zgjidhjes së arsyeshme.

Jo pak, por përgjatë shekullit XX pati prirje të ngrihet dialekti gegërisht në periudhën e monarkisë, ndërsa në periudhën e pasqirimit prirje pati dialekti i toskërishtes; në demokraci kemi të bëjmë me një botëkuptim të dyzuar. Albanologjia po vuan mjerimin konfliktual të ideve kohore, që përfaqësojnë ideologjikisht dhe aspak në këndvështrimin shkencor, vizionar për një përfaqësim të vetëm kombëtar. Të kultivohet njëri dialekt si gjuhë shkrimi apo letrar dhe të lihet tjetri jashtë përdorimit zyrtar, shkollor, juridik, do të thotë të thahet dalëngadalë ekzistenca e tij në botime e gjuhë të gjallë.

Të mendohet si një përzierje eklektike prej dy dialekteve themelore dhe të lihen pa u vjelë vlera nga nëndialektet, do të thotë të punohet pa kritere e parime të sakta. Kjo për faktin se Kristoforidhi nuk ishte plotësisht për një përzierje të të dy dialekteve, por duhet kërkuar në “prestigjin” që gëzonte toskërishtja në atë kohë. Këtë e ndien edhe Shoqëria e Stambollit, aq sa edhe gramatikën e saj e shkroi toskërisht.

Me një fjalë, për të shmangur çdo keqkuptim nga të dy dialektet kryesore të Atdheut pa lënë mënjanë nëndialektet, duke pasur parasysh edhe të folurën arbëreshe (të vjetër) të bëhej i mundur krijimi i një gjuhe kombëtare duke e ruajtur nga fjalët e padokumentuara e të saktësuar nga goja e popullit ose nga rindërtimet shkencore.

Kristoforidhi dha piketat kryesore të dialekteve e nëndialekteve se si do të shkruhen në një gjuhë të përbashkët.

Nga ana tjetër, ka edhe nëndialekte, për shembull, nga Malësia e Madhe, Mirdita, ku fjalorët si “Fjalori toponomastik” i dom Nikollë Gazullit dhe ai i Gjeçovit nuk mund të injorohen.

Dialekti shkodran, me përfaqësuesit e vet dinjitozë e të nivelit kombëtar, dialektet e Lumës, Dibrës, Tiranës, Beratit, Vlorës, Korçës, me Kosovën, nga shqiptarët e Maqedonisë dhe të Malit të Zi e duan atdheun të tërë dhe nuk ka asnjë motiv justifikues për të mos arritur standardet e një gjuhe të përbashkët pa nënvleftësuar apo mbivlerësuar në dëm të unifikimit kombëtar.

E, ç’është më e keqja, t’i japësh të drejta një nëndialekti për një pozicion gjeografik midis dy dialekteve, veri – jug, për hir të shmangies së divergjencave apo pretendimeve të tyre, do të thotë të krijosh artificialisht një bërthamë bipolare pa frymëmarrje kombëtare të vërtetë. Do të ishte një zgjidhje arbitrare, me një rezervë kulturore të cekët të elementeve pasurore gjuhësore.

Elbasani përfaqëson një nëndialekt që amortizon dhe toleron vlerat veri-jug, që e nderon misionin e kryer për gati 100 vjet, por ky dialekt i mesëm (i artë) për albanologët e dy dialekteve gegë e toskë nuk i bëri dot në një mendje këto 100 vjet.

Në mjaft burime letrare reflektojnë efekte të një toskërishteje eklektike, të gegërishtes dhe, e kundërta, kur në vend të formës gegërishte është përdorur trajta toskërishte, domethënë, një simbiozë bastarde, arbitrare, e improvizuar apo, siç e ka

quajtur studiuesi i mirënjohur Selman Riza: "... një monstrum linguisticum". Pra, një përzierje e tillë e dy dialekteve, veri e jug, nuk është zgjidhje për lartësinë e një gjuhe letrare të përbashkët.

Pretendimi se letërsia e Veriut ka tradita më të lashta dhe është më origjinale, më e konservuar dhe më e pasur se ajo e Jugut, ka argumentet e veta të drejta. Ky dallim nuk është esencial për të dalë dialekti verior më i pranuar se ai jugor, por ka disa veçori dokumentare historike e kulturore të tilla:

- Doktrinën kishtare katolike, qysh më 1462 nëpërmjet kryepeshkëvit të Durrësit Pal Engjëlli e gjejmë të shkruar shqip në "Formulën e Pagëzimit". Prifti italian i shek. XVIII, Giammaria Biemmi, është autor i monografisë së parë mbi Skënderbeun, të botuar në Venedik më 1480, me pseudonimin Antivarius.

Pastaj vijojnë Gjon Gazulli, Marin Barleti, Marin Beçikemi, Dhimitër Frangu e deri në linjën Fishta, Gurakuqi, Mjeda etj. që krijuan një gjeopolitikë të gjerë territoriale kombëtare. Kjo traditë pati në Perëndim gjuhën latine të lëvruar prej arbëreshëve të Italisë, por edhe autorë romakë e jo pak austro-germanë në veprat e tyre albanologjike.

- Një përkrahje të veçantë gegërishtja pati gjatë Monarkisë, por edhe nga Instituti i Studimeve Shqiptare në vitet 1940-1944 dhe në diasporë, Ernest Koliqi me revistën "Shejzat" në Romë e më gjerë dhe propaganda për gegërishten u trajtua jo sipas kufijve politikë, por kombëtarë. Në "Shejzat" e vitit 1962, Karl Gurakuqi shkruante: "Gegërishtja asht përdorë nga auktorë të përmendun në çdo fushë gjuhësore me në krye poetin kombëtar Gj. Fishtën, të cilit deri sot nuk ia ka dalë asnjëri tjetër. Do të mjaftoheshin veprat e tij poetike për të parapëlqyer dialektin e Veriut, pse në vjetët e kalueme ky dialekt pat qenë zgjedhë për të trajtue gjuhën letrare".

"Komisia letrare" e mbledhur më 1917, në të cilin bajshin pjesë autoritetet ma të nalta gjuhësore toskë e gegë për mbrojtjen dhe lavrimin e gjuhës amtare, për ta ngrejtun atë në shkallën e një gjuhe letrare të përbashkët, nuk reshtën asnjëherë që nga Bogdani e deri emnat e nderuar të shkodranëve si Pashko Vasa, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi dhe të sa burrave të tjerë..." (Shih "Albanica", viti 1992, fq. 121).

"Nuk duhet harrue se edhe kryeqyteti gjendet ku janë shkri

të folmet e ndryshme në një gjuhë që pak nga pak asht tue zanë vendin e një gjuhe të përbashkët.”

Jo pak “argumente” që, në fakt, për mua si shqiptar, më tepër ndajnë sesa bashkojnë, se cili dialekt është themeli, sillen më shumë nga autorë të Shqipërisë së Jugut. (Me një fjalë, aspak pakti Fishta – Frashëri më 1908 nuk vijoi, por u konfrontua Veri-Jug). Argumentet për toskërishten si gjuhë më e vjetër, më e pasur dhe më e përhapur janë: Të lidhur me trevën kombëtare iliro-epirote dhe doktrinën ortodokse që pasoi gjuhën greke. Shembujt nxirren nga librat fetarë, arvanitët, çamërishten. Namik Resuli nga Berati thekson: “Sipas statistikës sime, vendin e parë nga vjetërsia e zënë dialektet e shqiptarëve të Italisë e të Greqisë, të dytën çamërishtja, të tretën toskërishtja përkëtej Çamërisë, të katërtën gegërishtja e të pestën shkodranishtja”. (Shih: “Shkëndija”, nr. 4, 1940, fq. 21).

Çështja, edhe pas Luftës së Dytë Botërore, nuk u shtrua që të zhduket gegërishtja apo toskërishtja, ashtu siç interpretohet në polemikën klasore të Arshi Pipës ndaj Androkli Kostallarit, por të një bashkëqenieje të dialekteve paralele gegë-toskë me më të mirat që përfaqësonin shqipen dhe jo “krahinorizmat” e secilës.

Mirëpo edhe letërsia e Jugut ka bukurinë e kulturën e vet të veçantë, gjë që e bën konkurrente të denjë.

Për të qenë një gjuhë zyrtare, sipas principeve shkencore, pretendime ka historia, administrata shtetërore, botimet juridike e shkollore jo thjesht për drejtshkrim, por të niveleve bashkëkohore: të jetë përfaqësuesja shkencore e burimeve më origjinale shqiptare e tërë dialekteve dhe nëndialekteve të saj më të mira.

S’është utopi, por fillimisht përzgjedhja cilësore e pastrimi i fjalëve në territoret gjuhësore Veri e Jug dhe për gjuhën e kombit polemika të jetë e arsyeshme, shkencore, patriotike. Të tillë përfaqësues më autoritarë të mendimit vendas dhe përvoja e huaj do të sjellin atë standard modern që meritojmë si qytetarë europianë që jemi.

Baza e arsytimit më çon në një nga motivet e mosrealizimit shkencor, gjatë 100 vjet shtet shqiptar, të misionit tonë kombëtar për një gjuhë të përbashkët. Do të sjell argumentet përkatëse si dhe komponentët e mundshëm për një rezultante të ardhshme

kombëtare.

Përvoja e trashëguar në vend dhe ajo e huaj është trajtuar në botëkuptim diabolik. Në këtë argument nuk pretendoj të marr përsipër një ballafaqim studimor, as dhe një ide për zgjidhje kompetente aktuale në sintezën e saj përfundimtare.

Polemikat janë të mbartura, sa të vjetra po aq edhe të reja në kushtet historike kombëtare e shtetërore, aq sa përfaqësimi ynë dhe në këtë fushë nuk përputhet me natyrën strukturore që meriton populli ynë.

Të parët tanë i ruajtën themelet e gjuhës shqipe nga kohët më të vjetra e deri në shkrimin e saj duke fituar ndaj të gjitha ndarjeve e përçarjeve shekullore.

Letërsia e vjetër e të folurit shqip nëpër këngë, legjenda, gojëdhëna, fjalë të urta e deri zakone, doke, kanun apo rituale fetare, provon ekzistencën e një gjuhe nga më të lashtat në Ballkan.

Europa lexoi në letërsinë gjermano-austriake për shqiptarët, në veprat e Hahn më 1854, Fallmerayer më 1857 deri më 1860, Gustav Mayer më 1877 etj. Pati mendime më të ndryshme të mbrapshta: Disa e quajtën shqipen një dialekt i mbetur italisht e, për rrjedhojë, shqiptarët ishin degë e tyre. Jo pak sajesa pati nga fqinjët tanë tokësorë. Mendimi më dashakeqës i këtyre të fundit ishte: "Shqiptarët nuk kanë një gjuhë të përbashkët, por vetëm dialekte që nuk i kuptojnë as ata vetë".

Në një polemikë të tillë, më 15 nëntor 1912, në Budapest, kur u mbledh Këshilli i Shtetit të Austro-Hungarisë, miku ynë gjerman, abati dr. Helmer, për këtë problem u tha kundërshtarëve të çështjes shqiptare: (Po veprojmë ashtu si) Julianus Apostata për gjuhën gjermane që kumbon porsì këlthitja e korbave dhe ulërima e ujqve". Qysh në atë kohë, ky filozof i madh i romakëve tha këto fjalë për gjuhën gjermane.

Gjermanët ishin një popull i madh, por, megjithatë, nuk kishin një gjuhë letrare. Në këtë kohë të vjetër nuk ka pasur aspak gjuhë letrare gjermane, bavareze të vjetër, franke të vjetër dhe në fund, përsëri tri dialekte të tjera.

Një gjuhë letrare e përbashkët lindi vetëm nga vitet 1350 deri në vitin 1500. "Kur doli Martin Luteri dhe e përdori në vepra e në librat e tij, ajo ishte e kryer me vërejtje, duke e përdorur gjuhën

që ishte kudo e kuptueshme.” (Rev. “Leka”, v. 1937).

Namik Resuli, në studimin “Përpyetje të herëshme e të vona për një gjuhë shqipe të përbashkët” (Botuar në rev. “Shkëndija”, nr. 4, tetor 1940, fq. 17-32), në lidhje me reformat e kombeve ballkanike, për këtë çështje shkruan: “Fatbardhësisht, nuk jemi të parët ne shqiptarët që vuajmë në Ballkan për një gjuhë të përbashkët. Të gjitha shtetet e tjera ballkanike janë gjetur përpara këtij problemi pa e zgjidhur mirë plotësisht”.

Greqia e sotme ka dy gjuhë letrare, madje në kundërshtim të rreptë me njëra-tjetrën. Gjuhën e “kulluar” a katharevusa, e diturive dhe e kishës, që e ka origjinën në traditën gjuhësore antike bizantine... dhe gjuhën “popullore” krejt të pavarur nga evolucioni i gjuhës së kulluar.

Në Bullgari dallohen dialektet lindore nga ato perëndimore.

Në Rumani nisi të njësohej atëherë kur rilindësit e tyre kombëtarë të shekullit XVIII filluan ta pastrojnë gjuhën nga fjalët e shumta ballkanike, turke, sllavishte, duke i zëvendësuar me neologjizma latine, frëngjisht dhe italisht.

Në Turqi, përpara mbretërimit të Mustafa Qemalit nuk kishin dy gjuhë, por tri gjuhë letrare: turqishten popullore, të mesme dhe të stolisur. Në vitin 1940, sipas orientimeve të Atatürkut, u ngrit një komision i posaçëm gjuhësor, duke e pastruar gjuhën nga fjalët e huaja arabishte e persishte dhe duke i zëvendësuar me fjalë thjesht turke.

Atëherë, përse na mungon gjuha e përbashkët, pa një kompromis, marrëveshje, konsensus mbarëkombëtar në këto 100 vjet shtet?

Pa dashur të polemizoj për arsye të mosshmangies nga tema e trajtimit tim, bëj pyetjen: Çfarë gjuhe fliste Skënderbeu? Pal Engjëlli mund të ketë lënë ndonjë provë dokumentare. Të gjithë princat që e rrethonin, ishin: Dukë si Gjergj Balsha, Karl Topia, Gjin Bua Shpata, Arianit e Pal Dukagjini. Atëherë, përse të ngrihet hipoteza që Skënderbeu fliste gjuhën epirote?

A. J. Kullurioti, më 19 shtator 1879, në gazetën “Zëri i Shqipërisë”, në kryeartikullin e datës 27 tetor 1879 fliste për gjuhën shqipe: “Po themi neve të vërteta se gjuha shqipe atë kohë flitej në krejt Epirin dhe pothuajse në tërë Greqinë. Ndër ditët e kryengritjes helenike, që të gjitha ushtritë e Greqisë flisnin shqip...”.

Idea kombëtare shqiptare, ekzistenca e kombit shqiptar, gjuha, tradita për herë të parë patën apologjinë e De Radës në polemikat e kohës. De Rada, me një kërkesë iu drejtua diplomacisë europiane për përhapjen e letërsisë shqiptare.

Qysh më 1 shkurt 1927, "Dituria" e Lumo Skëndos shkruante: "Frangu i Bardhë në parathënie të fjalorit latinisht - shqip thotë se: "Gjuha jonë po vdiuret dhe po bastardohet". Kjo frazë është jo si një qortim për të folurën me gojë, por për të besuar se shqipja përdorej si gjuhë e gjallë dhe praktike në kohët që shkroi Frangu i Bardhë. Po kështu Bogdani etj.

Atëherë: Me këto të merren studiuesit e fushës albanologjike e jo se sa vlerë ka një dialekt i Veriut mbi atë të Jugut dhe anasjelltas. Retorika do të jetë mjaft lakonike, për arsye se secila përbën tematikë më vete, që shtrohet: Komisia Letrare e Shkodrës, 1917. "Përpyetje e autorëve gegë për një gjuhë letrare të përbashkët nga Bogdani deri më 1917".

Dy dialektet jetuan pranë e pranë duke plotësuar njëri-tjetrin dhe duke ruajtur veçoritë krahinore. Ky vlerësim i përket institucionit në kohën e Zogut.

Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972 në Tiranë. Pretendimet e dialektit të Veriut se: "Ngatërrohet me njehsimin e gjuhës letrare çështja e drejtshkrimit". "Studimet trajtohen sipas politikës gjuhësore të Partisë, që vendosi toskërishten letrare në bazë të gjuhës letrare. U ndalua gegërishtja letrare. Pra, nuk ndodhi bashkekzistenca e të dy dialekteve". Këto dhe të tjera dalin nga "gjuhëtarët shkodranë" në letrën që i dërguan më 11 nëntor 1992 Akademisë së Shkencave, ku edhe propozojnë për një kongres të tretë: Mbi problemet e gjuhës letrare të përbashkët. [Shih: Albanica, nr. 3-4, 1992, fq. 123-128].

Qemal Haxhihasani në "Dialektologjinë shqiptare" vetëm për çamërishten ka një kontribut që, e them me superlativa, gati të paarritshëm nga asnjë tjetër deri më sot. Përse nuk u treguan mirënjohës ndaj kësaj figure shkencore. Këtu hyn në mes "biografia". Ky autor, po për "biografinë", nuk u motivua me punimet e tij origjinale për mbledhjen e fjalëve në mjaft nga trevat tona jugore përgjatë ekspeditave të ndryshme.

## 2. A ka zbulime të reja?

Pjetër Bogdani, në parathënie të veprës së tij shqipe “Cuneus Prophetarum”, shtypur më 1685, tregon se ka pasur akoma libra të tjerë të shkruar shqip prej tij, por që rrugës, ose fati i keq “i kanë tretur si kripa në ujë”.

Në “Dituria” të Lumo Skëndos, nr. 1-2, 1927, kemi të shkruar: “Më 1909, kur isha në Elbasan për kongresin e shkollave, pashë tek z. Lef Nosi, po nga ky qytet, një dorëshkrim të vogël shqip, një liturgji të Theodhor Haxhi Filipit”.

Dhe vazhdon më tej L. Skëndo: “Më 1913, kur qeshë në Shkodër, i njohuri vjershëtar Atë Gjergj Fishta më thoshte se gjenden në duar të disa shokëve të tij priftërinj një mbledhje vjershash të priftit të Mirditës, Zarisht, i vdekur rreth vitit 1780”.

“Në Berat, më 1913, kisha parë tek z. Sulo Resuli një dorëshkrim shqip, por me shkronja turqishte...”.

“Në Berat prapë mbahen dhe ruhen dorëshkrime të tjera të vjershëtarëve Hasan Zyko Kamberi dhe Nezimit (Frakulla - A.K.)

Po nga revista “Dituria”, datë 1 maj 1927, në ciklin me titull “Udhëtarët e huaj në Shqipëri” lexon: “Gjermani Arnold von Harf ka ardhur në një udhëtim të shkurtër në Shqipëri dhe kemi një shkrim më i vjetri i shtypur deri më sot mbi gjuhën shqipe”.

“Hafiz Ali Ulqini më thotë se ka lënë një fjalor shqip - turqisht, një tjetër turqisht - shqip si dhe dy libra të tjerë, të mbetur akoma në dorëshkrim”.

Eduard Browni, mjek shëtitës më 1669, flet mbi përshtypjet e veta përgjatë udhëtimit, duke nisur nga Hungaria e deri në Prilep e Manastir. Viziton edhe Shkupin dhe prej andej shkon në Kaçanik e Prishtinë. Për këtë racë, autori flet në fq. 7 të kujtimeve të veta: “Tërë në atë mënyrë pësuam edhe me gjuhën e Shqipërisë, në pjesën veriore të Epirit dhe në perëndim të Maqedonisë. Disa prej tyre, në malet ku shkonim, flisnin pak sllavisht, por, sa për shqipen, për gjuhën e tyre në të cilën këndonin këngë ditë e natë, me gëzim të madh, kur udhëtonim neve. Askush prej tyre që dinin mirë gjuhët e huaja, turq apo të krishterë, nuk kuptonte gjë”.

Dr. Hahn, gjuhëtar dhe historian, mësoi nga Kostandin Kristoforidhi dhe argumenton se shkrimi shqip është shumë i vjetër, ku *abc*-ja jonë ngjan me *abc*-në fenikase.

Pikërisht letërsia gjermano-austriake bëri të njohur letërsinë shqipe të vjetër. Hahn, në veprën e cituar në vitin 1854, Fallmerayer, Gustav Meyer etj. në studimet e tyre shprehen: Teza që mbrojnë: Shqipja si gjuhë origjinale dhe nuk pranojnë të hedhin dyshime për këtë fakt.

Mit'hat Frashëri sqaron se kur Shqipëria thirrej Epir, atëherë edhe Skënderbeu emërohet "Epirotum princeps". Ndërsa Bogdani në veprën e vet të vitit 1685 nuk di kurrë të thotë *gjuha shqype*, por *gjuha epirote*.

Gjuha në dy komponentët e vet, të folurën në popull dhe sipas dokumenteve shkencore, ka nevojë të vihet në dritë dhe në themele të shëndosha për albanistikën – si një degë më vete e gjuhës indoeuropiane.

Luigj Gurakuqi, Hil Mosi, Primo Doçi apo Ndre Mjeda, që kishin ndikim vendimmarrës në vilajetin Shkodër – Shkup, dhanë shembull madhor konsensusi demokratik. Ata dhe të tjerët, Frashërllinjët apo tërë Shoqëria e Stambollit e hapën rrugën e tyre kombëtare sepse patën një gjuhë mirëkuptimi të përbashkët.

Hil Mosi lavdëroi punë e Frashërllinjve, ndërsa Mit'hat Frashëri iu përgjigj për shërbimet që i ka bërë Shkodra gjuhës shqipe dhe vlerën që kanë shkodranët. [Rev. "Leka", 28 nëntor 1937 (Kongresi i Manastirit)].

### 3. Cilat hipoteza nuk janë provuar si "teza" mbi gjuhën ilire?

HansKrahekaservirësi "teza" mbi gjuhën ilire "Mbishkrimet". Prej ilirishtes së vjetër njihet materiali epigrafik që na kanë lënë disa fise ilire në tokën e Gadishullit të Apenineve, që përbëjnë objekt studimi në shekullin XX dhe aktualisht.

Kur vijmë më 3-4 mars 1969, në "Sesionin shkencor kushtuar problemit ilir dhe gjenezës së shqiptarëve" nga Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë pranë Universitetit të Tiranës, lexoj vetëm konstatime dhe asnjë provë të dokumentuar në gjuhën ilire.

Gjuhëtarët tanë me të dhënat e tyre kanë provuar se shqiptarët janë autoktonë në truallin e tyre dhe se shqipja është faza më e re e ilirishtes së vjetër.

Po më 29 nëntor 1969 zhvillohet Konferenca Albanologjike

me titull: “Toskërishtja apo gegërishtja?” Androkli Kostallari foli si drejtor i Institutit të Gjuhë-Letërsisë. Përfundimi: “Tu dha goditje e fortë gegërishtes”. Kjo sipas Arshi Pipës.

Përsëri më duhet retrospektiva e çështjes. Lexoj Maximilian Lambertz: “Posta e Shqypniës” (Tiranë, 2011) dhe na del një qëndrim në bazë parimesh e kriteresh shkencore e jo qëndrime emocionale.

Vangjel Koça në shkrimin e tij “Faik Konitza” (Rev. “Shkëndija” nr. 2, 1942, fq. 46-47) thotë: “Për gjuhën shqipe qenia e një Faiku ka qenë providenciale. Shoqëria letrare e Stambollit gjeti një shqipe, atë të Ungjillit të Grigor Argjirokastritit dhe atë të përkthimeve fetare të Kristoforidhit. Pa toskërishten e sotme, gjuhën letrare dhe unifikuar dialektet krahinore të Jugës ua detyrojmë pas Peshkopit të Eubesë, Faikut, Naimit, Çajupit dhe Fan Nolit”.

Teksa u hedh një sy shkrimeve që ky institut boton lidhur me gjuhën shqipe, kupton mirëfilli se nuk ekzistonte kurrfarë mllefi ndaj personaliteteve të gjuhës në jugun shqiptar. Janë pikërisht po këta anëtarë të Institutit të Studimeve Shqiptare që e pagëzuan Sami Frashërin si reformator të gjuhës shqipe pas përhapjes së atij alfabeti në letërsinë shqipe zyrtare. Ndërsa Mati Logoreci për Kristoforidhin është shprehur: “Luteri i Shqipërisë”.

Integrimi kulturor kërkon unitet shkencor dhe jo diversitet krahinor bindjesh. Për këtë na duheshin fakte e shembuj nga përvoja e vendit dhe ajo e huaj për të kuptuar shkallën e përgatitjes në ato nivele e standarde që kombet e tjera i kanë zgjidhur të paktën para 100 vjetësh.

Madje edhe vetë vepra letrare e Gjon Buzukut (1555) në revistën “Hylli i Dritës” (nr. 1, mars 1930, fq. 143-151) me titull “Gjyqi i linguistëve të huej për rreth librit të Buzukut”, studim i prof. dr. Norbert Joklit, më 5 shkurt 1930 ka mbetur i hapur deri më sot. Pyetja që na intereson: A ka vepër latine para Buzukut? Historiani pyet: Ku fillon gjuha me të folmen në popull?

#### 4. Disa synime për zgjidhje

Kërkohej një zgjidhje akademike, shtetërore, kombëtare le ta gjykojnë përfaqësuesit e tërë trevave tona kombëtare duke qenë të çliruar nga bindjet e vjetra politike për të arritur një përfundim

të ngjashëm me Kongresin e Manastirit që u paraqit në Kongresin e Dibrës. Kjo edhe për t'u prerë rrugën edhe disa fantazmave të reja, të cilat jo pak po shfaqen për të mos u bërë edhe në këtë çështje bashkë. Si dhe ç'është më e mira, është detyrë e shtetit mëmë me studiuesit e tij duke i lënë të lirë në profesionalizmin dhe patriotizmin e tyre me ata të Kosovës, Dibrës e Çamërisë apo diasporës e më tej. Ata e dinë vetë se burrat e mençur nuk i mungojnë atdheut dhe kjo jo si moral, por si atdhetarë. Duhet parë si emergjencë disa dukuri që duhen ndaluar menjëherë, të cilat janë hapur kundër interesave kombëtare. Sa për argument: Është e nevojshme që mjaft teorive, hipotezave, tezave, deklaratave e botimeve jo në shërbim të vendit t'u jepet një përgjigje unike edhe për këtë çështje madhore që na ka ndarë 100 vjet shtet - komb si gjuhë të përbashkët.

- Në një libër (ka shumë të tillë) kolonel Xhevdet Resulbegović, me titull "Diversioni i akademikut Resuli", botuar në vitin 2004 në Ulqin, lexova një mendësi jo thjesht armiqësore renegatësh, por edhe përllyerjen e mjaft personaliteteve të shquara kombëtare. Për shembull, në fq. 13 të librit kemi të shkruar: "Nuk e di përse kanë pranuar tezat politike, ideologjike dhe shkencore të akademikut Resuli, për shembull, Noel Malkolmi, Arshi Pipën, Sami Repishti, Isuf Luzaj etj. (vijon me 11 të tjerë) në Shqipëri e kudo". Në fq. 14 kemi: "Bilé morën guxim të pranonin tezat e akademikut Resuli edhe kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof. Aleks Buda, si edhe vetë prof. Eqrem Çabej...".

E këto "përgëzime" janë nëpër tezat e Kapllan Resulit se: "Albanët nuk ishin ilirë...", se në vitin 1994 në Gjenevë paska botuar gegërisht "Tradhtinë", për të cilën mori një përgjigje dinjitoze nga Dritëro Agolli (ndërsa për Kadarenë, S. Shkupin etj. çfarë nuk përgojon). Ndërsa vetëquhet "Mandela i Shqipërisë", "Ungjilli i patriotizmit shqiptar" (fq. 51). Në fq. 54-56 lexon në fushën e albanologjisë, njeh si "merita" dëmet që i ka bërë me ide varrmihëse, ndarje, tjetërsim, shpifje në të gjitha fushat.

Mirëpo, kur shfrytëzon këto fakte, atëherë ndaj këtij sharlatani anormal s'është për të heshtur, sepse ndryshe është pohim. Në fq. 56 kemi: "Docenti Anastas Dode e ka futur në leksionet e veta që mbante në Universitetin e Tiranës"; "Emëruan K. Resuli sekretar me statut dhe nënpresident i asaj akademie". "Në vitin 1995 i

është propozuar posti i presidentit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë” (por ai ka refuzuar). “Në vitin 1991 ka refuzuar edhe për deputet në parlamentin shqiptar” etj.

E di që nuk ia vlen të merresh me të, por nuk ka asnjë oponent zyrtarë shqiptarë për të.

Është fakt se edhe tematika e studimeve shkencore nga institucionet tona ka qenë konstatim e aspak origjinale dhe në terren përkatës. Një historian apo letrar do të dijë me fakte konkrete çfarë ke zbuluar (domethënë, jo kopje nga albanologët austriakë, gjermanë etj.). Çfarë pune kërkimore si kohë e praktikë ke observuar; sa e ke pasuruar dhe me çfarë elementesh origjinale, apo sa hipoteza ke argumentuar me prova dokumentare si teza, ose e kundërta, ato që nuk qëndrojnë nga faktet e reja. Pa bëjeni këtë bilanc dhe do të kuptohet domosdoshmëria e referimit dhe e standardit shkencor. Kjo, sepse të tjera shkruan revista “Albanohellenica” e vitit 1999, nr. 1, ku Aristotel Spiro, pedagog në Universitetin e Athinës, shkruan për temën e “huazimeve”, “ndikimeve”, “prejardhjes” etj. të fjalëve shqipe nga greqishtja. Për shembull, në fq. 18, nga ky autor në këtë botim lexon: “Greqishtja ka qenë gjuhë e shkruar e qyteteve ilire”; “Prania e huazimeve të lashta greke në shqipe përdoret edhe si argument për autoktoninë e hershme të shqiptarëve në trojet e sotme”. Për këto huazime, autori përdor studimet e Çabejt, Kostallarit, Lambertzit etj. Si përfundim, del me zbulimin e vet edhe Dhori Qiriazit për huazimet greke në shqipen e sotme duke u bazuar në punimet etimologjike të Çabejt (fq. 33).

Ndërsa në fq. 76 lexon: “Prej greqishtes, burimit të saj të njëmendtë”. Atëherë, përse nuk bëhet polemika për këto qëndrime të fqinjëve dhe jo pak si të pastrojmë neologjizmat nga thesari i gjuhës sonë që ekziston i pashfrytëzuar si në terren edhe nga dorëshkrimet e pabotuara etj.

- Lexoj në “Gjurmime albanologjike” nga Instituti Albanologjik i Prishtinës i viteve 1975-1977 dhe buletinet për shkencat shoqërore e deri studimet historike të Institutit të Historisë deri në vitin 1990 asnjë oponent për autorët serbë në çështjen albanologjike. Madje edhe Fehmi Pushkolli në

“Gjurmimet albanologjike” të vitit 1978 shkruan: “Tito - 40 vjet në krye të Partisë”.

Në vitet 2001-2002 lexoj nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës si dhe nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë vetëm një “garë” elozhesh midis tyre si miq para vitit 1990 pa prekur e pastruar gjuhën letrare shqipe nga grindjet “Veri-Jug” të Shqipërisë, por se kush është më patriot për Kosovën.

Ja përse e prek këtë temë, sepse është një çështje e shtruar para një shekulli. Se cili do të ketë “dafinat”, e ka në dorë rezultati dhe jo ofiqi për të qenë i parë.

## Bibliografi

- J. Kullurioti. Gazeta “Zëri i Shqipërisë”, 27 tetor 1878.  
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Studime, 8-9, 2001-2002.  
Buletin për Shkencat Shoqërore. 1954-1958.  
Aleksandër Xhuvani. “Përpyekja shqiptare”, fq. 22-27.  
Dora D’Istria”. “Për çështjen kombëtare shqiptare”, Tiranë, 1977.  
Faik Konica. “Shkëndija”, nr. 2, maj 1942.  
Franz Babinger. Ilyria, 28 mars 1936.  
Gazeta “Drita”, 21 maj 1972, fq. 14.  
Hans Krahe. “Bota si histori”, Nr. 6, 1942.  
Ismail Ahmeti. “Hafiz Ali Korça”, Shkup, 1999. (Kongresi i Dibrës).  
Johan Georg von Hahn. “Studime shqiptare”, Jena, 1853.  
Kolonel Xhevdet Resulbegoviq. “Diversioni i akademik Resulit”, Ulqin 2004.  
Maximilian Lambertz. “Posta e Shqypniës”. Shtëpia Botuese “Botart”, 2011.  
Mit’hat Frashëri. “Diturija”, fruer, maj 1927 dhe mars 1928.  
Mit’hat Frashëri. “Përpyekja shqiptare”, tetor 1936, fq. 11-14.  
Namik Resuli. “Shkëndija”, tetor, nr. 4, 1940, nr. 7, 1941, nr. 2 dhe nr. 7, 1942.